



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1559/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike” Sh.A (KESCO), me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.191/22 i datës 15.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.04.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit, “Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike” Sh.A (KESCO), me seli në Prishtinë, e datës 07.11.2023, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.191/22 i datës 15.10.2023, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin e atakuar me ankesë, e ka refuzuar si të pabazuar, kërkesëpadinë e paditësit, Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike” Sh.A (KESCO), kundër të paditurit Zyra e Rregullatorit të Energjisë me seli në Prishtinë (ZRRE), për anulimin e Bordit të ZRRE-së, me nr. V_1128_2019 të datës 28.03.2019 me numër protokoll nr.213/19 të datës 15.04.2019 me propozim që gjykata ta aprovoj padinë si të bazuar, ti anuloj vendimet e Bordit të ZRRE-së si të pa bazë dhe jo të ligjshëm. Ndërsa secila palë bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka ushtruar ankesë paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të anulohet Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.191/22 i datës 15.10.2023 si i kundërligjshëm, të aprovohet kërkesëpadia e paditësit KES/CO ” Sh.A Prishtinë dhe anulohet vendimi i ZRRE-së nr. V_1128_2019 të datës 28.03.2019, si i paligjshëm.

E paditura ZRRE në përgjigje në ankesë, pretendimet ankimore të paditësit i konteston si të pa bazuara, i propozon Gjykatës Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë, ankesën e ushtruar nga Kompania Kosovare për Furnizim me Energji KESCO, ta refuzon si të pa bazuar, ndërsa Aktgjykimin

e Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.191/22 të datës 15.10.2023 ta vërtetoj.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura me vendimin nr. V_1128_2019 të datës 28.03.2019, në pikën I. të dispozitivit ka aprovuar ankesën e konsumatorit N.B., nga fshati Studenqan, Suharekë si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi, në pikën II. ka obliguar KESCO që konsumatorit me shifër DPZ- ... ti anuloj korrigjimin plotësues nr....DPZ-... të datës 08.12.2014 në vlerë prej 8,734.86€.

I pakënaqur me vendimin e ZRRE, paditësi, me padi inicion konflikt administrativ në gjykatë me të cilën e konteston ligjshmërinë e vendimit të atakuar dhe kërkon anulimin e tij. Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Administrative, më datë 20.09.2023, mban seancë të shqyrtimit kryesor në prani të palëve ndërgjyqëse, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor bien aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar. Në arsyetim ndër të tjera ka theksuar se gjykata ka vlerësuar ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 43 dhe 44 të LKA-së dhe ka gjet se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Gjykata ka vlerësuar se Bordi i ZRRE-së drejtë ka vlerësuar gjendjen faktike me c' rast në vendimin kontestues ka theksuar se duke u bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike është konstatuar se konsumatori ka luhatje në shpenzim të energjisë elektrike, për periudhat kontestuese me njehsorin elektrik nr.3575516 dhe njësorët elektrik nr.96256873 dhe nr.9783027 për periudha të njëjta kohore. Korrigjimi plotësues nr. ... DPZ-... i datës 08.12.2014 në vlerë financiare 8,734.86€ për faturat e periudhës 12/2013 deri në periudhën 11/2014 është bërë duke ri-faturuar faturat e asaj periudhe për shkak të mos matjes së saktë të njehsorit elektrik pa u përcaktuar vlera e pa saktësisë, bazuar në rregullat e përcaktuara në Kodin e Matjes së Energjisë Elektrike Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS-2020)përkatësisht neni 4.11 Pasaktësia e Matjes në rastin konkret sipas dispozitës në fjalë konsumatorët duhet të korrigjohen pas përcaktimit të vlerës së pasaktësisë "+" "-", dhe pa u bërë testimi i pajisjeve matëse nga Qendra e Kalibrimit. Sipas nenit 3.8.4 të Kodit të matjes vlerëne saktësisë (përcaktohet) pas kalibrimit që të mundësoj kontrollimin e mundëshëm në ndonjë periudhë të kërkuar kohore të përcaktuar sipas Rregullatorit dhe standardeve ndërkombëtare për energji elektrike. Mënyra e verifikimit të njehsorit nga laboratorit i kalibrimit është përcaktuar në udhëzimin administrativ të lëshuar nga MTI-ja dhe kodi i matjes. Sipas Rregullës së Procedurës për Identifikimin dhe Parandalimin e Shfrytëzimit të paautorizuar të Energjisë Elektrike (2009), neni 8 paragrafi 4 procesverbali i plotësuar me konstatimet teknike nga punonjësit e laboratorit të kalibrimit të përcaktuar në paragrafin dërgohet te komisioni i cili duhet të jetë i përbërë prej së paku tre anëtareve një nga OSSh-ja kurse dy nga furnizuesi. Përkundër që KEDS nuk ka arritur të konstatoj shkakun e defektit nga ka rezultuar regjistrimi i pasaktë nuk ka konstatuar llojin e

intervenimit nga ekipet në teren, nuk ka siguruar verifikimin e njehësorit nga laboratorit i kalibrimit po ashtu nuk i ka dorëzuar as listat e leximit për periudhën 05/2014 deri në periudhën 02/2015 të kërkuara nga ZRRE në mënyrë që të argumentoj korrigjimin shtesë me nr....DPZ-... të datës 08.12.2014 në vlerë prej 8,734.86€. Prandaj, gjykata ka vlerësuar se nga provat e administruara nuk është vërtetuar një gjendje tjetër faktike nga ajo që i padituri e ka vërtetuar në procedurë administrative. Prandaj, ka vlerësuar se ZRRE ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi kur ka vendosur që të aprovoj ankesën e konsumatorit N.B. dhe të obligoj KEDS-paditësin që konsumatorit me shifër DPZ-... ti anuloj korrigjimin plotësues me nr....DPZ-... të datës 08.12.2014 në vlerë prej 8,734.86€.

Dhoma e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, duke e shqyrtuar aktgjykimin e shkallës së parë në bazë të ankesës së paditësit dhe sipas detyrës zyrtare, të njëjtin e konfirmon në tërësi si të drejtë të bazuar në prova dhe ligj. Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të ligjit për konfliktet administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 49 të LKA dhe nenit 194 të LPK-së.

Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në baza ligjore ka vlerësuar ligjshmërinë a aktit përfundimtar administrativ, si në vështrim të nenit 43 dhe 44 të LKA, dhe drejtë ka vendosur kur të njëjtin e aprovon si ligjor dhe të drejtë pasi që edhe kolegji vlerëson se Vendimi i ZRRE është përmbajtjesor ashtu si parashihet me nenet 84,85 dhe 86 të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe i bazuar në dispozitat ligjore materiale-Ligjin për Rregullatorin e Energjisë dhe Rregulloren për zgjidhjen e kontesteve në sektorin e energjisë, e gjithashtu në mënyrë të plotë është vërtetuar edhe gjendja faktike e çështjes dhe nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit me rastin e vendosjes së çështjes, lidhur me refuzimin e ankesës së paditësit ndaj vendimit të Bordit të ZRRE-së për konsumatorin N.B., me të cilin vendim i është aprovuar ankesa konsumatorit, me të cilën ka kundërshtuar përgjigjen e lëshuar nga KESCO si dhe ka kërkuar ti shqyrtohet korrigjimi plotësues nr....DPZ-... i datës 08.12.2014. ZRRE vendimin e saj e bazon në kodin e matjes përkatësisht në nenin 3.9.4 dhe 3.9.5 si dhe në nenin 4.3.2 ku përcaktohen qartë detyrimet e OSSH-së lidhur me inspektimin dhe testimin e njehësorëve brenda periudhave të caktuara kohore, si dhe përgjegjësinë mbi operimin dhe mirëmbajtjen e njehësorëve elektrik.

Pretendimi i paditësit se njehsori në periudha të caktuara nuk prezanton matje dhe nuk regjistron energji elektrike është fakt i pa kontestueshëm dhe fakt i provuar edhe me procesverbalin nr. 1241282 i datës 14.11.2014 sepse me rastin e ndërprerjes së furnizimit të tensionit në njehsor dhe aktivizimit të të njëjtit vërteton faktin se njehsori ri testohet dhe fillon të prezantoj të dhëna dhe regjistrimin e energjisë elektrike, fakt i vërtetuar edhe nga leximet e AMR të cilat janë lexime softuerike dhe ruhen në ADVANCE me të cilin saktë nxirret koha e humbjes së matjes dhe bllokut të leximit ku vërtetohet se nuk ka pasur regjistrim të energjisë elektrike dhe një numër i konsiderueshëm ka zero shpenzim ndërsa duke i krahasuar matjen e daljeve distributive në rrjedhën e rrymave në drejtim të konsumatorëve kemi rrjedha energjetike, por pika matëse e konsumatorit evidenton rrjedhimisht zero. Këtë pretendim Dhoma e Shkallës së Dytë e refuzoj si të pa bazuar për faktin se korrigjimin shtesë me nr. ...DPZ-... të datës 08.12.2014 në vlerë prej 8,734.86€ nuk ka arritur ta argumentoj me prova konkrete pasi që nuk ka konstatuar saktë shkakun e defektit nga ka rezultuar regjistrimi i pasaktë, llojin e intervenimit nga ekipet në teren nuk ka siguruar dëshminë lidhur me verifikimin e njehësorit nga laboratorit i kalibrimit, dhe nuk ka dorëzuar listat e leximit për periudhën 05/2014 deri në periudhën

02/2015, në mënyrë që ti lejohet korrigjimi plotësues me nr...DPZ-... i datës 08.12.2014 në vlerë prej 8,734.86€.

Kolegji duke i shqyrtuar dhe vlerësuar pretendimet ankimore të paditësit për mos vërtetimit të gjendjes faktike nga gjykata e shkallës së parë dhe cenimit të drejtës materiale të cekura si në arsyetim të ankesës, kolegji i vlerëson si të pa bazuara në prova dhe fakte të argumentuara, sepse nuk i referohen gjendjes së çështjes në shqyrtim duke i bazuar pretendimet edhe në dispozita ligjore konkrete në bazë të cilave do të dëshmohej me bazë e drejta e pretenduar dhe shkeljet e bëra nga gjykata. Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë në seancat e mbajtura në këtë çështje ka vërtetuar gjendjen faktike në tërësi dhe drejtë ka vendosur kur e len në fuqi, duke e vlerësuar si ligjor vendimin e organit të paditur, andaj pretendimet ankimore janë të pa ndikim për të ndryshuar gjendjen dhe për të vërtetuar gjendje faktike tjetër nga ajo e vërtetuar nga organi administrativ përfundimtar në procedurë administrative ZRRE, dhe në procedurë gjyqësore nga Dhoma e Shkallës së Parë, sepse nuk dëshmohet se organi i paditur ka vepruar në kundërshtim me ligjin.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1559/23, me datë 16.04.2024

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami